



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 1058 prot.

Shkodër, më 21.01. 2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin shtesë:

“Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit social për vitin 2025, për realizimin e një kati shtesë në objektin: Banesa Sociale me Qira (Ish-Konvikti i Shkollës Veterinare), i përshtatur për strehim social”.

Duke ju uruar punë të mbarë.
Me respekt,



Relacion: 3 faqe
Certifikatë Pronësie: 4 faqe
Njoftim MEKI: 1 faqe
Pr/Vendim: 2 faqe
Nr. kopje: 4 kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT

Nr. 1058/1 prot.

Shkodër, më 21.01. 2025

RELACION

“Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit social për vitin 2025, për realizimin e një kati shtesë në objektin: Banesa Sociale me Qira (Ish-Konvikti i Shkollës Veterinare), i përshtatur për strehim social”.

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar; VKM nr. 454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”; VKM nr. 458, datë 03.07.2019 “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore”; VKM nr. 579, datë 22.07.2020 “Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët e përkohshme, të kriterëve dhe procedurave”; VKM nr. 405 datë 01.06.2016, Strategjia e Strehimit Social 2016 – 2025; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 33 datë 26.08.2020 “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”, Udhëzimit nr. 31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025 – 2027 të Bashkisë Shkodër”, si dhe shkresës nr. 15900 datë 18.12.2024 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”, paraqitet pranë jush relacioni si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër synon të aplikojë në thirrjen e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me projektin “Banesa Sociale me Qira (Ish-Konvikti i Shkollës Veterinare), Shtesë Kati II, i përshtatur për strehim social”, pasi prej disa vitesh bashkia po zbaton projekte me synim rritjen e fondit të banesave sociale për familjet dhe individët më në nevojë, duke rikonstruktuar dhe vënë në përdorim objekte publike pronë të Bashkisë Shkodër, si në ish konviktin e shkollës Pyjore dhe në ish konviktin e shkollës Veterinare. Sipas kriterëve dhe termave të referencës së thirrjes për

projekte, përkatësisht pika 2.3.3.b “Përmbajtja e dosjes së aplikimit dhe dosjes së plotë të projektit, për cdo kategori programi” për projekt propozimet në fushën e “Banesë Sociale me qira” që sigurohet nëpërmjet adaptimit të objektit ekzistues, në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, është i nevojshëm miratimi në parim nga ana e Këshillit Bashkiak i vlerës së bashkëfinancimi nga buxheti i bashkisë.

Projekti parashikohet të realizohet në një godinë ekzistuese e cila është rikonstruktuar dhe përshtatur në banesë sociale si rezultat i financimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pas aplikimit e në bashkëfinancim me Bashkinë Shkodër në vitin 2020. Aktualisht janë ndërtuar 28 njësi banimi pjesë e fondit publik të banesave sociale në pronësi të Bashkisë. Kjo godinë e ish konviktit të shkollës Veterinare është e zënë në mënyre informale prej më tepër se 25 vitesh dhe aktualisht është rikonstruktuar dhe krejtësisht e gatshme për akomodimin e 28 familjeve sipas programit Banesa Sociale me Qira.

Aktualisht janë sistemuar 26 familje përfituese të cilët përfitojnë strehim të përshtatshëm brenda standarteve të përcaktuara. Me VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025 – 2027 të Bashkisë Shkodër” është parashikuar fisha buxhetore P.AG141.Q6.O1.A2 “Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit (Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i IshKonviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II)” dhe për maksimizim të ndërhyrjeve dhe përdorim eficient të fondeve të bashkisë dhe fondeve të Qeverisë propozohet aplikimi për realizim të këtij projekti përmes bashkëfinancimit.

Projekti shtesë i një kati, në një godinë publike dhe funksionale, do të rriste me tej efektivitetin e godinës duke rritur numrin e njësisve të banimit dhe numrin e individëve dhe familjeve përfituese që nuk mund të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm.

Nga vlerësimet e specialistëve rezulton se në këtë objekt është e mundur të realizohet një shtesë kati dhe të përfitohen edhe 14 njësi banimi të tjera, duke e kthyer këtë godinë në një pallat me 42 apartamente e duke shtuar me tej kontigjentin e banesave sociale me qira në Bashkinë Shkodër.

Projekti është preventivuar me një vlerë prej 56,563,064 lekë dhe punimet parashikohen të kryhen në 5 muaj. Bashkëfinancimi për këtë projekt propozim sipas kërkesave të thirrjes do të jetë 30% e vlerës së projektit.

Sa më sipër kërkojmë nga ana e Juaj:

1. Miratimin në parim të bashkëfinancimit për realizimin e një kati shtesë në objektin Banesa Sociale me Qira (ish-Konvikti i shkollës Veterinare), i përshtatur për strehim social.
2. Përqindja e bashkëfinancimit do të jetë 30% të vlerës sipas preventivit total të punimeve me vlerë 56,563,064 lekë, ku:
 - Bashkia Shkodër angazhohet të bashkefinancojë projektin në masën 30 % në vlerë 16,968,919 lekë të preventivit total.
 - Buxheti-i-Shtetit bashkefinancojë projektin në masën 70% në vlerë 39,594,145 lekë të preventivit total.
3. Burimi financimit do të jetë fisha buxhetore P.AG141.Q6.O1.A2 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit (Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social,

(Rikonstrukcion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II), Programi AG141
Përkujdesi Social.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, Ju ftoj ta votoni propozimin për miratimin e projekt
vendimit.

KRYETAR



Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Artim Kruja

Drejtorja e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së
Objekteve Publike

Glazë Kulla

Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm
Ekonomik

Edum Mema



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËTËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA SHKODER	K36813001H	1/1

Numri i Pasurisë	12/1120		
Kodi Unik	8591063081		
Zona Kadastrale	8591		
Lloji i Pasurisë	TRUALL		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 742	Truall: 742	Ndërtesë: 742
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	SHKODER, SHKODER, Rr.: -		

DREJTORI
Granit Korbi

Santilian
0

Digitally signed by:
Santiliano Stani
Date: 2024.12.11
03:23:07 +02'00'

Digitally signed by:
Albi Pritfi
Date: 2024.12.11
03:57:31 +02'00'

Digitally signed by:
Granit Korbi
Date: 2024.12.11
04:08:09 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkodër
Date: 2024/12/11 15:23:12 +02'00'
K36813001H2024121115230494L1014

ASHK
AGJENCIA SHETËTËRORE E KADASTRËS

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8591063081

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8591, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 12/1120, Sipërfaqja Totale 742 m2,
(Nga të Cilat Truall 742 m2; Ndërtesë 742 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale -, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia SHKODER, Rruga -, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 421, Dt. 02/06/2010), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA SHKODER, Nr. Identifikimi/NIPT K36813001H, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia -, Rruga 13 DHJETORI, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. 421, Datë: 02/06/2010

Regjistruar: Nr. 00022906, Datë: 28/08/2024

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. __, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. __, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËRËRE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbledhës	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkuës	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbledhës	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: VKM 421 DATE 02.06.2010 NE PRONESI KONVIKTI SHKOLLES VETERINARE

DREJTORI
Granit Korbi

Santillan

Digitally signed by:
Santillano Stani
Date: 2024.12.11
03:22:40 +02'00'

Albi

Prifti

Digitally signed by:
Albi Prifti
Date: 2024.12.11
03:57:18 +02'00'

Data e lëshimit
Granit Korbi

Digitally signed by:
Granit Korbi
Date: 2024.12.11
04:07:07 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkodër
Date: 2024/12/11 15:22:18 +02'00'
K36813001H2024121115221187ASHK

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtrënore e Kadastrës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 8591

KODI UNIK: 8591063081

NUMRI PASURISË : 12/1120

INDEX I HARTËS: SH-H-5

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



Albi
Prifti

Digitally signed by:
Albi Prifti
Date: 2024.12.11 15:58:33 +02:00

Digitally signed by:
Granit Korbi
Date: 2024.12.11 04:06:33 +02:00

DREJTORI
GRANIT KORBI

Data e leshimit 11.12.2024



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkodër
Date: 2024/12/11 15:58:33 +02:00
K36813001H2024121115582412014

SHPJEGUES

□ PARCELA
■ NDERTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)



J. Sout

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E STREHIMIT

15900
Nr. ____ / Prot.

18 12
Tiranë, më ____ / ____ / 2024

Lënda: Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025.

28105
26.12.2024

BASHKISË

SHKODËR

ADRESA E TITULLARIT:

Në zbatim të ligjit "Për buxhetin e vitit 2025" dhe ligjit 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, ju bëjmë me dije mbi hapjen e thirrjes për projekte të reja për programet e strehimit për vitin 2025; mbi Termat e Referencës, afatet, Dosjen/ Formularët e Aplikimit dhe kushtet për përfitimin e fondeve buxhetore.

Dosja e Aplikimit, dokumentacioni që do të shoqërojë formatin e aplikimit, kriteret skualifikuese, tabelat përkatëse, sistemi i pikëzimit dhe kufijtë e financimit/ bashkëfinancimit për çdo kategori projekti jepen në lidhjen nr.1 dhe lidhjen nr.2 (bashkëlidhur), miratuar me Urdhër Ministri.

Të gjitha tabelat përmbledhëse të listave emërore të dërgohen edhe në soft copy, në formatin excel, në adresën e email-it: _____;

Lidhjet nr.1 dhe nr.2 do të publikohen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në adresën: _____

Duke Ju falënderuar,



MINISTËR
Blendi GONXHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. 1058/prot.
12

Shkodër, më 21.01. 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2025

“Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit social për vitin 2025, për realizimin e një kati shtesë në objektin: Banesa Sociale me Qira (Ish-Konvikti i Shkollës Veterinare), i përshtatur për strehim social”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës . 2025, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar; VKM nr. 454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”; VKM nr. 458, datë 03.07.2019 “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore”; VKM nr. 579, datë 22.07.2020 “Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët e përkohshme, të kriterëve dhe procedurave”; VKM nr. 405 datë 01.06.2016, Strategjia e Strehimit Social 2016 – 2025; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 33 datë 26.08.2020 “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”, Udhëzimit nr. 31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025 – 2027 të Bashkisë Shkodër”, si dhe shkresës nr. 15900 datë 18.12.2024 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025” sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të bashkëfinancimit për realizimin e një kati shtesë në objektin Banesa Sociale me Qira (ish-Konvikti i shkollës Veterinare), i përshtatur për strehim social.
2. Përqindja e bashkëfinancimit do të jetë 30% të vlerës sipas preventivit total të punimeve me vlerë 56,563,064 lekë, ku:

- Bashkia Shkodër angazhohet te bashkefinancoje projektin në masën 30 % në vlerë 16,968,919 lekë të preventivit total.
 - Buxheti i Shtetit bashkefinancon projektin në masën 70 % në vlerë 39,594,145 lekë të preventivit total.
3. Burimi financimit do të jetë fisha buxhetore P.AG141.Q6.O1.A2 Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit (Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJVV për strehim social, (Rikonstruksion i Ish-Konviktit të Shkollës Veterinare, Shtesë Kati II), Programi AG141 Përkujdesi Social.
 4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv. Kryetar

Ornid Vajsi

Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Arllinda Kruje

Drejtorja Juridike

B. Leqepol

Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Bekim Keme

Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Arbë Hoxha

Drejtorja e Përgjithshme e Mirëmbajtjes Së Objekteve Publike

Gjergj Kullo

Drejtorja e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse

Sen. S. Keshi